



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“RIPARIME TË PAJISJEVE ELEKTROSHTËPIAKE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

E3-III-19

Tiranë, qershor 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake”			Kodi E3-III-19
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për kryerjen e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë <i>personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</i>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake të niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në Kualifikimin “Elektroteknikë” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK - janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të riparimeve e shërbimeve për pajisjet elektroshtëpiake, firma që prodhojnë apo shesin pajisje elektroshtëpiake. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin teknik/menaxher. Me arsimim të mëtejshëm (niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK) fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-II-03-12			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Riparim Pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

NJOHURI PROFESIONALE

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës

- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit dhe vendosjes së elementeve, pajisjeve dhe mjeteve për procese të ndryshme pune;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të vendit të punës për realizimin e një riparimi të një pajisjeje elektroshtëpiake;
- Të listojë veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdoren në procese të ndryshme pune për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të listojë aparatet matës që përdoren për matje, si dhe gjatë diagnostikimit apo riparimit të pajisjeve të ndryshme elektroshtëpiake, duke përshkruar veçoritë dhe përdorimin e tyre;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës personale;
- Të shpjegojë parimet e etikës profesional;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të shpjegojë parimet e punës në grup;
- Të shpjegojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një komunikim;
- Të dallojë terminologjinë teknike të profesionit;

Makina dhe transmise elektrike

- Të shpjegojë veçoritë e makinave elektrike të tipeve të ndryshëm;
- Të shpjegojë veçoritë dhe ligjet mekanike të transmiseve elektrike;
- Të analizojë vetitë elektromekanike të tipeve të ndryshme të motorëve elektrike;
- Të interpretojë paraqitjen grafike të tipeve të ndryshme të motorëve elektrike;
- Të shpjegojë mënyrat e lëshimit dhe rregullimit të shpejtësisë së makinave elektrike të tipeve të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrat e frenimit sipas tipit të motorit;
- Të rendisë tipet dhe veçoritë e pajisjeve komutuese;
- Të interpretojë skema të ndryshme të komandimit të pajisjeve elektrike;

Elektronikë industriale

- Të shpjegojë parimin e punës të përforcuesve të tipeve të ndryshme;
- Të përcaktojë llojin e përforcuesit në bazë të skemës;
- Të listojë veçoritë e secilit përforcues;
- Të shpjegojë parimin dhe kushtet e gjenerimit të sinjalit;
- Të shpjegojë ndryshimet ndërmjet gjeneratorit dhe përforcuesit;
- Të listojë tipet e gjeneratorëve sipas funksionit;
- Të shpjegojë funksionimin e portave të thjeshta logjike;
- Të interpretojë skemat e drejtuesve elektronikë industrialë;
- Të tregojë rolin e burimeve të ushqimit në qarqet elektrike;
- Të analizojë skema të ndryshme ushqyesish;

Ndërtimi dhe funksioni i pajisjeve elektroshtëpiake

- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e sobës elektrike;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e Mikrovalës;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e shtrydhësit të frutave Mikserit;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e fshesës me korrent dhe aspiratorin;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e ekspresit e kafesë;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e makinës larëse të rrobave;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e makinës tharëse të rrobave;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e makinën larëse të enëve;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e frigoriferit shtëpiak;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e hekurin profesional;
- Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e kondicionerit;

Mirëmbajtje, riparim apo zëvendësim i pjesëve

- Të shpjegojë shërbimet e mirëmbajtjes të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes të pjesëve të veçanta të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përshkruajë skemën elektrike funksionale të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të interpretojë skemën e montimit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të shpjegojë rëndësinë e dëgjimit të klientit dhe marrjes së informacion përkatës;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të pajisjes dhe instalimeve përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e matjeve të parametrave të pajisjes me aparate përkatëse për diagnostikimin e defekteve të saj;
- Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të matjeve të kryera me dokumentacionin teknik të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përshkruajë procedurat teknike të çmontimit dhe montimit të pajisjeve elektroshtëpiake;

- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së materialeve të duhura për riparim;
- Të shpjegojë legjislacionin e magazinimit për ruajtjen në mënyrë efektive të materialeve të nevojshme dhe lëndët e para, si dhe pajisjet e ndryshme;
- Të përshkruajë procesin e riparimit dhe/ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të pajisjes, duke u nisur nga skema teknike apo udhëzimet e prodhuesit ose blerësit;
- Të shpjegojë rëndësinë e testimet pas riparimit;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të preventivit për riparimin e kryer;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të faturës për shërbimin e kryer;
- Të listojë defektet kryesore të sobës elektrike, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të mikrovalës, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të shtrydhësit të frutave mikserit, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të fshesës me korrent dhe aspiratorin, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të ekspresit e kafesë, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të makinës larëse të rrobave, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të makinës tharëse të rrobave, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të makinën larëse të enëve, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të frigoriferit shtëpiak, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të hekurin profesional, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të listojë defektet kryesore të kondicionerit, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimeve të tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së kondicionerit;
- Të përshkruajë procesin e dokumentimit të punës së kryer;

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të kërkesave të sigurisë në punë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin në punime të ndryshme gjatë riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse për mos rënien nën tension gjatë riparimit të pajisjeve

elektroshtëpiake;

- Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të përshkruajë veprimin e rrymës elektrike në trupin e njeriut, llojet e dëmtimeve që shkaktohen prej saj;
- Të analizojë rolin e tokëzimit mbrojtës dhe kushtet e realizimit të tij;
- Të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet mbrojtëse specifike individuale dhe kolektive të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të shpjegojë nevojën e sistemimit dhe evakuimit të mbeturinave dhe produkteve të dëmshme, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;

Bazat e sipërmarrjes

- Të shpjegojë sipërmarrjen dhe elementet e saj, si dhe lidhjen me veprimtarinë njerëzore;
- Të shpjegojë funksionet e sipërmarrjes dhe organizimit të punës në biznes;
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave, institucionet financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojë konceptet bazë të legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të listojë llogaritjet e thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të shpjegojë rëndësinë, mjetet, strategjinë e marketingut;
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Riparim të pajisjesve elektroshtëpiake”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK individit do të zotërojë shprehitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës

- Të organizojë vendin e punës për realizimin e një riparimi të një pajisjeje elektroshtëpiake;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për procese të ndryshme pune për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përdorë aparatet matës, veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdoren gjatë diagnostikimit në procese të ndryshme pune për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përgatitë mjetet, pajisjet, materialet e nevojshme sipas përdorimit të tyre;
- Të mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës;
- Të respektojë standardet e punës gjatë diagnostikimit të defektit dhe riparimit të tij në

pajisjet elektroshtëpiake;

- Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm gjatë punës për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- Të zbatojë parimet e etikës profesional;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të respektojë parimet e punës në grup;
- Të përdorë terminologjinë teknike të profesionit;
- Të komunikojë me profesionalizëm me klientin;

Makina dhe transmise elektrike

- Të dallojë veçoritë e makinave elektrike të tipeve të ndryshëm;
- Të zbatojë kushtet e lëshimit dhe rregullimit të shpejtësisë së makinave elektrike të tipeve të ndryshme;
- Të mirëmbajë pajisjet komutuese;
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparime të thjeshta të makinave elektrike;
- Të vizatojë skema të ndryshme komandimi të pajisjeve elektrike;
- Të realizojë skema të ndryshme komandimi të pajisjeve elektrike;

Elektronikë industriale

- Të montojë përforcues të tipeve të ndryshme;
- Të përzgjedhë llojin e përforcuesit në bazë të skemës;
- Të përzgjedhë tipin e gjeneratorit në bazë të skemës;
- Të përzgjedhë porta të thjeshta logjike sipas funksionit;
- Të lexojë skemat e drejtuesve elektronikë industrialë;
- Të përzgjedhë burimet e ushqimit në qarqet elektrike;
- Të montojë skema të ndryshme ushqyesish;

Menaxhimi i mjeteve, materialeve, pjesëve dhe dokumenteve

- Të identifikojë mjetet, materialet dhe pjesët e nevojshme për pajisjet e ndryshme;
- Të ruajë në mënyrë efektive materialet dhe pjesët e nevojshme, si dhe pajisjet e ndryshme në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me legjislacionin e magazinimit;
- Të përzgjedhë materialet dhe pjesët e nevojshme, si dhe pajisjet e ndryshme, në sasinë e duhur, sipas nevojës;
- Të klasifikojë dhe përdorë dokumentacionin teknik të përshtatshëm (fletët e të dhënave, diagramet, udhëzimet për përdorim, etj.) për zgjidhjen e problemeve teknike;
- Të lexojë vizatime dhe udhëzime të prodhuesit, simbole të ndryshme të përdorura në to;
- Të kontrollojë artikujt e nevojshëm të përzgjedhur për riparime;

- Të zgjedhë ofruesin më të mirë, në bazë të llogaritjeve teknike -ekonomike;
- Të përgatitë një urdhër blerjeje, duke respektuar terminologjinë e tregtisë dhe seksionet e ndryshme të dokumentit;
- Të kryejë porosinë sipas urdhrin të blerjes;
- Të sigurojë marrjen e mallrave në dorëzim duke kontrolluar gjendjen e tyre përmbajtjen e paketimit, pajisje, udhëzime për përdorim etj.;

Instalimi i pajisjeve

- Të realizojë montimin, duke ndjekur rregullat në operacionet e ndryshme në përputhje me standardet, teknikat, autorizimet ligjore dhe udhëzimet e prodhuesve;
- Të zbatojë teknikat e instalimit dhe fiksimit mekanik të pajisjes (instalim i lirë, i pandërprerë ose i integruar);
- Të kryejë punime plotësuese sipas nevojës.
- Të përshtatë pjesën e re të pajisjes, sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Të kryejë rregullime dhe teste operative duke përdorur dokumente të përshtatshme dhe pajisje matëse dhe kontrolli;
- Të kontrollojë hapjet dhe mbylljet e dymve;
- Të kontrollojë stabilitetin, vibrimet, akustike etj.;
- Të këshillojë klientin duke shpjeguar operacionet bazë të përdorimit;

Mirëmbajtje, riparimi, zëvendësimi i pjesëve

- Të analizojë skemën elektrike funksionale të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të zbatojë skemën e montimit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të kryejë kontrollin vizual të pajisjeve elektroshtëpiake para riparimit;
- Të dëgjojë versionin e klientit, të marrë të dhëna dhe t'i kërkojë atij informacion përkatës;
- Të realizojë matje të parametrave të pajisjes me aparate për diagnostikimin e defekteve të saj;
- Të krahasojë matjet e kryera me dokumentacionin teknik të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të dokumentojë vëzhgimet dhe diagnozën e riparimit dhe / ose zëvendësimit në një kartë raportimi;
- Të zbatojë procedurat teknike të çmontimit dhe montimit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për riparim;
- Të kryejë riparime ose zëvendësime të pjesëve të dëmtuara të pajisjes duke u nisur nga skema teknike, udhëzimet e prodhuesit ose blerësit;
- Të kryejë testimet pas riparimit;
- Të hartojë preventivin për riparimin e kryer;
- Të përgatisë faturën për shërbimin e kryer;
- Të plotësojë fletë garancinë e shërbimit të kryer;
- Të diagnostikojë dhe riparojë Sobën elektrike dhe i Mikrovalën;

- Të diagnostikojë dhe riparojë Shtrydhësin e frutave Mikserin
- Të diagnostikojë dhe riparojë Fshesën me korrent dhe Aspiratorin;
- Të diagnostikojë dhe riparojë ekspresin e kafesë ;
- Të diagnostikojë dhe riparojë makinën larëse të rrobave;
- Të diagnostikojë dhe riparojë makinën tharëse të rrobave;
- Të diagnostikojë dhe riparojë makinën larëse të enëve
- Të diagnostikojë dhe riparojë frigoriferin shtëpiak
- Të diagnostikojë dhe riparojë hekurin profesional
- Të diagnostikojë, riparojë dhe mirëmbajë kondicionerin.
- Të kryejë shërbime të ndryshme mirëmbajtjeje për pajisjet elektroshtëpiake;

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë kërkesat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të përdorë pajisje mbrojtëse specifike individuale dhe kolektive për të realizuar detyrat e dhëna dhe parandaluar aksidentet në punë;
- Të zbatojë masat mbrojtëse për mos rënien nën tension në instalimet elektrike;
- Të zbatojë standardet teknike për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të japë ndihmën e parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të kryejë sistemimin dhe evakuimin e mbeturinave dhe produkteve të dëmshme, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;
- Të selektojë materialet e riciklueshme;

Bazat e sipërmarrjes

- Të krijojë një plan biznes të vogël në fushën e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Të parashikojë bashkëveprimin me bankat, institucionet financiare në biznes;
- Të zbatojë kërkesat e legjislacionit fiskal dhe atij të punës;
- Të përcaktojë funksionet e sipërmarrjes dhe detyrat kryesore të personelit;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të

ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.

- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij. për të nxënë gjatë gjithë jetës.